

## RELACION

### MBI

#### Raportet e monitorimit të buxhetit për periudhën Janar – Gusht 2023

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të 8-mujorit të vitit 2023 për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar për të siguruar realizimin e Qëllimit dhe objektivave të synuara të Institucionit.

#### 1. Qëllimi dhe objektivat e programit

Qëllimi i Politikës së programit tonë është: “Menaxhimi efektiv, efikas, i drejtë dhe transparent i të ardhurave doganore”. Për periudhën janar-prill 2023 Administrata doganore e ka realizuar planin e të ardhurave në masën 94.1%.

“Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” është:

- të mbrojë interesat financiare dhe ekonomike të Shqipërisë
- të kontribuojë për sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë
- të lehtësojë tregtinë, të bashkëpunojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë aktorët përkatës.

Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregtinë dhe sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar.

Objektivi 1. Krijimi i lehtësirave për operatorët ekonomik nëpërmjet lehtësimit dhe përsheptimit të procedurave doganore. ADSH do të vazhdojë të përmirësojë procedurat doganore dhe të akcizës në mënyrë që të rritet mbledhja efikase e detyrimeve. Vëmendje e veçantë do të vihet në harmonizimin e mëtejshëm me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira, veçanërisht në implementimin praktik të legjislacionit.

Dixhitalizimi i shërbimeve doganore ka sjelle lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës proceduriale, rritje të transparencës dhe ulje të korrupsionit.

Objektivi 2. Garantimi i sigurisë dhe i mbrojtjes kombëtare nga: kontrabanda, trafiqet paligjshme, mallrat e ndaluara e fallsifikuara, evazioni fiskal etj.

Gjatë kësaj periudhe janë ushtruar kontrole në të gjithë territorin doganor, akset rrugore, si dhe në porte dhe hapësirat tona detare, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme janë realizuar gjithsej 2616 inspektime doganore. Nga Drejtoria e Antikontrabandës (Sektori Tokësor & Detar), janë ushtruar 1412 kontrole, nga të cilat 87 ose 13.24% kanë qenë të plota. Gjatë kontrolleve të ushtruara, janë zbuluar 43 raste me shkelje doganore me një vlerë totale 9,085 mijë lekë.

Grupet e Antikontrabandës, kanë monitoruar dhe bërë shoqërime të Tranziteve Ndërkombëtare të cigareve, si dhe kontrole dhe shoqërime të autoboteve me karburant dhe dokumentacionit shoqëruar, në zonat doganore: Durrës - Elbasan - Qafë Thanë - Aks - Hani Hotit/Muriqan dhe

Morinë.Nga Drejtoria Antitrafik janë ushtruar 1204 kontrole në Pikat e Kalimit Kufitar ndaj individëve/udhëtarëve, automjeteve, mjeteve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave. strukture janë

Drejtoria e Hetimit nisur nga informacione të strukturave të tjera të DPD-së, apo për çështje të nisura kryesisht pas mbledhjes së të dhënave si dhe kryerjes se veprimeve paraprake, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen e veprave penale të parashikuara në legjislacionin penal në fushën e doganave për shmangje të detyrimeve doganore apo detyrimeve të akcizës sipas përcaktimeve të nenit 277 të ligjit nr. 102 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ka përgatitur dhe ka dërguar pranë Organit të Prokurorisë gjatë kësaj periudhe gjithsej 5 referime, janë konstatuar 8 shkelje doganore kundërvajtje administrative, janë konstatuar 7 shkelje doganore kontrabandë , janë dërguar Degëve Doganore 16 informacione për marrje vendimi.Gjatë periudhës Janar – Gusht 2023 kanë qenë në proces hetimi çështje me karakter sensitiv apo kërkesa për verifikim nga të cilat, janë trajtuar 3024 çështje dhe mbyllur 1320 çështje.

ADSH do të fuqizojë më tej aktivitetet dhe veprimet që kontribuojnë në sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë, ruajtje më të mirë të shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Një rëndësi e veçantë do t’i vihet luftës kundër shkeljeve ndaj IPR si dhe Materialeve të ndaluara si drograve si dhe mallrat radioaktive.

## 2. Analiza e shpenzimeve faktike 8 mujore 2023

Në zbatim të ligjit nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, buxheti i fillestar I miratuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, programi buxhetor “Menaxhimi i të ardhurave doganore”, për vitin 2023 është 4,201,920 mijë lekë ndarë sipas zërave buxhetor:

- Shpenzime korrente 3,862,010 mijë lekë
- Shpenzime kapitale 339,910 mijë lekë

Gjatë periudhës Janar-Gusht 2023 ky plan ka pësuar ndryshime duke shtuar akordimin e fondit të veçantë të miratuar për programin tonë për vitin 2023, si dhe është akorduar fond shtesë për shpenzimet e personelit për mbulimin e efekteve financiare në zbatim të Vendimeve të Qeverisë për rritjen e pagave. Gjatë kësaj periudhe nisur nga ecuria e realizimit të shpenzimeve janë kryer rialokim fondi midis artikujve buxhetor.

Plani fillestar, plani i rishikuar si dhe realizimi i artikujve buxhetor për periudhën Janar-Gusht 2023 paraqitet si më poshtë:

*në 000/lekë*

Art	Emërtimi	Plan fillestar Viti 2023	Plan rishikuar vjetor	Realizuar janar-prill 2023	% e realizimit
600	Paga	1,155,110	1,302,217	801,293	62
601	Sigurime Shoqërore	190,900	218,453	133,724	61
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,506,240	2,443,741	1,486,273	61
605	Transferta Korente të Huaja	9,760	9,760	6,077	62
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	2,936	1,335	45
231	Financim i brendshëm	219,220	219,220	43,409	20
231	Financim i Huaj	120,690	120,690	4,205	3
		4,201,920	4,317,017	2,476,316	57

1. Shpenzimet e personelit (art 600+601).

Për mbullimin e efekteve financiare që rrjedhin nga vendimet e Qeverisë për rritjen e pagave të punonjësve plani fillesatë i fondeve të akorduara përmes ligjit vjetor të buxhetit 2023, në zërin e shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore) u shtua me akt normativ, Në raport me planin buxhetor Janar-Gusht këto shpenzimet janë realizuar në vlerën e rreth 935,017 mijë lekë ose rreth 62%. Struktura organizative e administratës doganore është e miratuar me Vendimin nr.355, datë 26.5.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.921 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore, të ndryshuar. Pagesa punonjësve kryhet bazuar në Vendimin nr. 187, datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/ nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, Institucionet në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit” të ndryshuar.

2. Shpenzime për mallra e shërbime (art 602)

Ky zë shpenzimi zë peshën më të madhe specifike të fondeve të miratura 56.6% të totalit të buxhetit të miratuar. Nëpërmjet fondeve të miratuara në këtë artikull buxhetor mbështetet veprimaria operacionale e institucionit me mallra e shërbime (shtypshkrime, kancelari, kaburant, qira, udhëtim e djeta, abonime).shlyerja e detyrimeve të kontratës së konçesionit për skanimin e kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë kundrejt shoqërisë Rapiscan në zbatim të ligjit nr.74/2015 “Për miratimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues dhe Shoqërisë “S2 Albania” sh.p.k ,dhe “Rapiscan Systems”, INC “Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve” dhe “Për ndryshimin e marrëveshjeve së konçesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve dhe automjeve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.123/2013”, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit”.

Nisur nga ulja e kursit të këmbimit lek/euro (pasi detyrimet ndaj kontratës së konçesionit shlyen në monedhën euro) nga ky artikull buxhetor gjatë kësaj periudhe është kryer rialokim fondi duke ekualuar te shpenzimet e personelit.

3. Transferta korrente të Huaja (art 605).

Në këtë artikull janë planifikuar detyrimet e Institucionit tonë për anëtarësimin në Organizma Ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe është shlyer detyrimi ndaj Qendrës së Zbatimit të Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC) në shumën 25,620 Euro konvertuar në 3,000 lekë si dhe detyrimi ndaj Organizates Botërore të Doganave në shumën 3,076 mijë lekë.

4. Transferta për buxhete familjare e individë (606)

Për vitin buxhetor 2023, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i është planifikuar si Fond i Veçantë për mbullimin e rasteve të fatkeqësive, sëmundjeve dhe shpërblimit për dalje në pension pleqërie në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave vlera prej 2,600 mijë lekë. Ky fond gjatë kësaj periudhe është përdorur për 21 raste në vlerën gjithsej 1,335 mijë lekë,

5. Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm.

Për vitin 2023 me anë të ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është planifikuar për të realizuar investimeve në shumën 219.220 mijë. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka të

parashikuara fonde për blerjen e pajisjeve kompjuterike, pajisje teknike për laboratorin doganor, pajisje zyre si dhe pajisje elektronike. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar nga njesitë ekonomike të institucionit tonë blerja e 328 cope pajisje kompjuterike, 53 cope pajisje zyre si dhe 25 cope pajisje të tjera pritet që nga 4 mujorit i fundit i këtij viti të përfundojnë procedurat dhe të vazhdojnë procesin e likuidimit të detyrimeve kontraktuale që do të krijohen për pajisjet.

Gjatë vitit u krye rialokim fondi për blerjen e : “Skaner për kontroll bagazhesh” në shumën 21.500 mijë lekë për Degët Doganore Sarandë, Rinas, për kryerjen e kontrollit të bagazheve të pasagjerëve në mënyrë të shpejt dhe efikase të cilat do të shkurtojnë kohën e kontrollit dhe do të përmirësojnë cilësinë e tij.

Si dhe për “Blerje Kabina kontrolli” 4 cope në shumën 2,600 mijë lekë për sigurimin e ambienteve të nevojshme, për nëpunësit për ushtrimin e funksioneve zyrtare në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Krahas blerjes së pajisjeve janë të parashikuara edhe projektet:

“Rikonstruksion, Ndërtim e Rikonceptim i Degës Doganore Kapshticë”. Nga ana e Institucionit tonë me anë të shkresës nr 14725 prot datë 12.09.2023”Raportohen fonde të lira” shuma e parashikuar për këtë projekt është raportuar si fond i lirë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

“Zbatim i projektit Krijimi i ambienteve shtesë në Parkingun e Degës Doganore Morinë”. Realizimi i këtij projekti është në varësi të VKM për kalim pronësie e më pas për marrjen e lejes ndërtimit "Rikonstruksion i tualeteve të ndërtesës së Doganës Elbasan" në këto kushte fondet e parashikuara për këtë projekt u rialokuan.

6. Shpenzimet Kapitale me financim të huaj .

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj janë parashikuar për tu realizuar projektet :

-Zhvillimi i Moduleve të ITMS (Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifës) totalisht të përputhshëm me ITMS e BE-së. Me anë të këtij projekti synohet forcimi i kapaciteteve institucionale të Administratës Doganore Shqiptare. Projekti është në vijimësi

-Lëvizshmëria në Bregun Jonian - COMOBILON” në kuadër të Programit Interreg IPA Cross-border Cooperation “Greqi – Shqipëri 2014-2020“- Ndërtim, Rindërtim, Rehabilitim i PKK Qafë – Botë. Ky projekt ka përfitues DP e Policisë dhe DP e Doganave. Nga DP e Doganave do të kryhen blerje pajisjesh për të gjitha palët që operojnë në PKK. Aktualisht është lidhur kontrata për "Furnizim mobilje" në vlerën 12,925 EUR pa TVSH. Si dhe “Furnizimin për kabinat e kontrollit”, shuma e kontraktuar. 28,392.66 Euro. Aktualisht nga llogaria e projektit për pjesën e financimit të huaj janë likuiduar 4029 mijë lekë dhe likuiduar Tvsh në shumën 6,617 mijë lekë.

-Projekti PEN-CP në kuadër të Programit Horizon 2020. Projekti Pan-European i Praktikuesve Doganorë (PEN-CP) synon të ndërtojë një rrjet ndërmjet administratave doganore të caktuara për të krijuar një ekosistem për ndërveprimin, shkëmbimin e njohurive dhe inovacionit për të përmirësuar

sigurinë evropiane, për një kontroll më efikas të flukseve të tregtisë së paligjshme. Projekti ka filluar në vitin 2018 dhe afati për përfundimin e tij është shtyrë deri në muajin dhjetor 2025. Në muajin Prill 2023 në kuadër të këtij projekti u organizua në Tiranë takimi i katërt me pjesëmarrjen e 14 administratave doganor. Shuam ae realizuar nga ky projekt per periudhen janar-gusht 2023 është 175 mijë lekë.

#### 6. Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Krahas fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit gjatë periudhës janar-prill 2023 janë realizuar shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit si më poshtë:

*në 000/lek*

Nr	Emertimi	Fond i realizuar
1	Shpenzime personeli (600+601)	16,396
2	Shpenzime të tjera korente (602)	1,793
3	Shpenzime kapitale (231)	278
4	Transferta korrente të brendshme (art 604)	105,339
	TOTALI	123,806

Në shpenzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nga të ardhurat jashtë limitit përfshihen:

-Fondet e krijuara nga vendosja e sanksioneve doganore në zbatim të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.919, datë 29.12.2014 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 285,

-Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, dhe Strukturës Përgjegjëse për Doganat Shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë si dhe nga operatorët ekonomikë në ambjentet e të cilëve ka prezencë të personelit doganor.

-Gjithashtu nga ana e Institucionit tonë gjatë periudhës Janar-Gusht 2023 është kryer transfera prej 105,339 mijë lekë njësisive vendore për rentën minerare të shfytëzuar në teritorin e tyre (art 604) në bazë të autorizimeve të lëshuara nga Ministria e Financave në zbatim të: Ligjit nr.157/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 ‘Për taksat kombëtare, të ndryshuar’”, në zbatim të Udhëzimit nr.12 datë 04.04.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare’, të ndryshuar.

DREJTOR I BUXHETIT DHE FINANCËS

Ilir Bereti